



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 23.19.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR
TË AUTORITETIT RREGULLATIV TË HEKURUDHAVE
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Ilir Abazi - udhëheqës i ekipit të auditimit, dhe Mirlinda Beqiri anëtare e ekipit, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Bujar Sejdiu.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	14
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	18
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	19
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	22
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	23

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 30/03/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se një pjesë e pagave ishin të parregullta, disa nga shpalosjet rreth buxhetit final nuk ishin prezantuar, avancet e pambyllura nuk ishin shpalosur, vlera e stoqeve nuk ishte e saktë dhe informatat për detyrimet nuk ishin të plota. Opinionin jonë nuk është i modifikuar për këto çështje.


Për më gjerësisht shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Kryesuesin e Bordit dhe ekipin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimi të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjija e Kryesuesit të Bordit

Kryesuesi i Bordit ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes.

Kemi audituar PFV-të e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullores MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Edhe gjatë vitit 2016 (për 10 muaj) ishte paguar shtesa për anëtar të Bordit në vlerë 4,900€ për ish-drejtorin ekzekutiv ndonëse Bordit i kishte skaduar mandati në vitin 2014. Po ashtu, kishte pranuar paga në vlerë 4,283€ (për korrik, gusht, shtator dhe tetor) pas skadimit të kontratës më 15/07/2016 ndonëse kishte vazhduar punën në ARH;
- Nuk janë prezantuar shpalosjet rreth buxhetit final sipas llojit të shpenzimeve për paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime si dhe shpenzime komunale;
- Informatat rreth detyrimeve të pa paguara nuk janë të plota, ndërsa detyrimet kontigjente nuk janë shpalosur;
- Avancet e pambyllura në fund të vitit në vlerë 6,780€, nuk janë shpalosur në PVF; dhe
- Vlera e stoqeve (5,247€) nuk është e saktë.

Shkaku i dobësive të identifikuar ishte mungesa e Bordit të ARH-së që ka rezultuar me dështim të kontroleve në menaxhimin e shpenzimeve, si dhe mungesës së një rishikimi kritik të procesit të përgatitjes së PVF-ve. Opinioni jonë nuk është i modifikuar për këto çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ARH-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

ARH kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga OB;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.06/2011;
- Raportin vjetor të punës;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrollit (MFK); dhe
- Planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara publike.

Në draft PFV ishin të nevojshme disa korrigjime financiare dhe kemi dhënë disa sugjerime për të përmirësuar cilësinë e tyre, si në vijim:

- Buxheti final ishte mbivlerësuar për 90,275€; dhe
- Shënime shpjeguese në PVF ishin të pasakta dhe jo të plota.

Në kontekst të PVF-ve finale kemi identifikuar që informatat për organizatën buxhetore si aktivitetet, legjislacioni dhe politikat kontabël nuk janë shpalosur. Dobësitë tjera janë prezantuar te pjesa 1.1 e këtij raporti.

Të gjeturat nxjerrin në pah mungesën e rishikimit kritik të PVF-ve nga menaxhmenti, i cili është i nevojshëm për të konfirmuar saktësinë dhe plotësinë e shënimeve.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave mund të konsiderohet e saktë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

1.3 Rekomandimi për pjesën e parë të raportit

Për çështjen e sipërpërmendur te theksimi i çështjes, ne japim rekomandimin si në vijim:

Rekomandimi 1 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes dhe që janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shpalosjet e kërkuara dhe pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet në MF, përveç kur ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për ARH-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore (OB) siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një OB të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për të përcaktuar cilësinë e pyetësorëve të plotësuar për vet-vlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuarra përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

ARH udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm i cili mandatohet nga Bordi Mbikëqyrës dhe njëkohësisht është antar i Bordit. Që nga viti 2014, kur bordit paraparak i kishte skaduar mandati, ARH ka funksionuar pa mbikëqyrje nga bordi. Në tetor të vitit 2016 Kuvendi i Kosovës ka caktuar Bordin Mbikëqyrës i cili ka një mandat pesë (5) vjeçar.

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda ARH-së veçanërisht në lidhje me hartimin e planit strategjik dhe menaxhimin e rrezikut. Pyetësi i vet-vlerësimit, i plotësuar nga ARH e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese që nuk bazohen sa duhet në dëshmi. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit duhet të përmbushen plotësisht. Menaxhmenti nuk ka dëshmuar proces të mirëfilltë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve tjera të monitorimit. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së Bordit Mbikëqyrës që nga viti 2014.

Në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin, auditimi ynë ka shpalosë ekzistencën e disa mangësive të cilat përfshijnë kryesisht menaxhimin e personelit si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve dhe mbikëqyrjes së pamjaftueshme nga menaxhmenti. Poashtu, ende nuk është vendosur një sistemi adekuat për menaxhimin e pasurisë.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraparak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 ka rezultuar në tri (3) rekomandime kryesore. ARH ka përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, një (1) rekomandim është zbatuar, një (1) ishte në proces të zbatimit dhe një (1) rekomandim ka mbetur i pazbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III. Inkurajojmë Drejtorin e Përgjithshëm që të vazhdojë me zbatimin e të gjitha rekomandimeve tona.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për ARH më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave (MF) në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 - Pyetësi i vetvlerësimit - Prioritet i lartë

E gjetura

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Pyetësi i vet-vlerësimit i plotësuar nga ARH nuk është kuptuar sa duhet dhe në disa raste përgjigjet e dhëna nuk prezantojnë gjendjen reale të institucionit. Sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut ende nuk janë funksionale sepse përgjegjësia për zhvillimin e menaxhimit të rrezikut nuk është rialokuar brenda organizatës. Vlerësimi me notë është mbivlerësuar për disa pjesë në kuadër të komponenteve të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
2. Strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit (përfshirë ndërlidhjen me palët e interesit si dhe sigurimin e strategjisë me kosto të plotë) konsiderohet si e vendosur nga manaxhmenti, mirëpo dëshmitë në mbështetje të këtij konkluzioni janë të pamjaftueshme. Kjo çështje është trajtuar më hollësisht në nënkapitullin 2.3.1; dhe
3. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura dhe të mbështetura nga ARH.

Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda ARH-së që ka të bëjë me rëndësinë e këtij pyetësi dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

Rreziku

Aranzhimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 2 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se është analizuar plotësisht i pyetësit të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë proaktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësit si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. Rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet zhvillimit të procesit të menaxhimit të rrezikut.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit ARH operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin implementimin e planeve strategjike në nivel të organizatës. Rregullat dhe udhëzimet e MFK-së përcaktojnë kërkesat dhe përgjegjësitë e organizatave për hartimin e planeve strategjike dhe përcaktimin e objektivave të organizatës.

Çështja 3 – Mungesa e planit strategjik – Prioritet i lartë

E gjetura ARH ende nuk ka hartuar planin strategjik në të cilën do të përcaktoheshin objektivat strategjike të cilat synohen të arrihen, përgjegjësit për koordinimin dhe zhvillimin e atij plani, si dhe llogaritjen e kostos së realizimit të strategjisë. Kjo gjendje është trashëguar nga Bordi i kaluar dhe ende nuk është adresuar nga Bordi i emëruar në fund të vitit 2016.

Rreziku Mungesa e planit strategjik redukton përcjelljen efektive të përmbushjes së objektivave në pikëpamje të vizionit të organizatës si një ndër kushtet esenciale të qeverisjes së mirë. Kjo pamundëson edhe zhvillimin e një procesi të mirëfilltë të menaxhimit të rrezikut, pasi ky proces ndërlidhet direkt me objektivat e përcaktuara me planin strategjik.

Rekomandimi 3 Kryesuesi i Bordit duhet të ndërmarrë veprime konkrete drejt procesit të hartimit të planit strategjik, si dhe të hartojë planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes së progresit dhe rezultateve.

2.3.2 Organizimi i brendshëm dhe raportimi menaxherial

Për të siguruar se sistemet financiare dhe operative funksionojnë siç duhet, menaxhmenti duhet të vendos një mjedis efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Është e rëndësishme që kjo të përfshinë organizimin e brendshëm, delegimin e duhur të përgjegjësive dhe raportimin e rregullt tek menaxhmenti, për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj sfidave dhe problemeve operative të identifikuar.

Çështja 4 – Struktura funksionale - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Organizimi i brendshëm respektivisht organogrami i ARH-së miratohet nga Bordi Mbikëqyrës (Bordi). Ish-Drejtori i Përgjithshëm me një vendim jo-formal kishte ndryshuar strukturën funksionale të ARH-së duke krijuar një divizion të ri pa miratim nga bordi për shkak që mandati i bordit kishte skaduar. ARH ende vazhdon të funksionojë me strukturën e ndryshuar nga ish-Drejtori i Përgjithshëm respektivisht me një strukturë të pamiratur nga Bordi.
- Rreziku** Funksionimi me një strukturë të pa aprovuar nga Bordi paraqet papajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe mund të rezultojë me aktivitete dhe operacione të parregullta.
- Rekomandimi 4** Kryesuesi i Bordit duhet të iniciojë rishikimin e strukturës aktuale të ARH-së dhe një organogram ta propozojë për miratim nga ana e Bordit jo më larg se 1 tetor 2017. Subjekt i rishikimit të Bordit duhet të jenë të gjitha operacionet e ARH-së që kërkohet të rishikohen nga Bordi e që janë zhvilluar gjatë periudhës pas skadimit të mandatit të bordit paraprak për të siguruar që janë në pajtueshmëri me rregulloret dhe kërkesat ligjore.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

ARH në strukturën e saj organizative nuk ka Njësi të Auditimit të Brendshëm. ARH nuk i plotëson kriteret ligjore për të pasur NjAB, pasi ka buxhet dhe numër të vogël të personelit. Vitin e kaluar aktivitetet e ARH-së ishin mbuluar me auditim të brendshëm nga Njësia Qëndrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm (NjQH/AB), ndërsa aktivitetet e vitit 2016 nuk iu ishin nënshtruar auditimit të brendshëm. Inkurajojmë Drejtorin e Përgjithshëm që në bashkëpunim me NjQH-në të sigurojë një formë të auditimit të brendshëm për të identifikuar dhe adresuar me kohë dobësitë potenciale në sistemet kyçe të ARH-së.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e pranimeve dhe shpenzimeve në organizatën buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në shumicën e rasteve kontrollet e brendshme janë të vendosura, zbatohen dhe janë duke funksionuar, megjithatë në aspekte të caktuara të sistemit kërkohen përmirësime të mëtejshme. Disa nga mangësit e identifikuar vitin e kaluar janë përsëritur edhe këtë vit. Kjo ngase nuk janë duke u zbatuar si duhet rregulloret, por edhe mungesës së mbikqyrjes së duhur nga menaxhmenti. Menaxhimi i personelit dhe menaxhimi i pasurisë jokapitale mbeten çështje që kërkojnë vëmendje të shtuar të menaxhmentit për avancim të mëtejshëm të mekanizmave të kontrollit me qëllim evitimin e mangësive ekzistuese.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	293,623	203,349	201,251	237,903	248,063
Granti i Qeverisë -Buxheti	293,623	203,349	201,251	237,903	248,063

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte më i ulët për 90,275€. Ky zvogëlim është rezultat i rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2016, ARH ka përdorur 99% të buxhetit final ose 201,251€, me një përmirësim prej 4% krahasuar me vitin 2015. Buxheti është realizuar në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenz. e fondeve sipas kategorive ekonomike:	293,623	203,349	201,251	237,903	248,063
Pagat dhe Mëditjet	167,544	124,918	124,918	123,270	117,641
Mallrat dhe Shërbimet	114,179	72,053	70,337	108,659	124,748
Shërbimet komunale	11,900	6,378	5,996	5,974	5,674

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Zvogëlimi i buxhetit për paga dhe mëditje për 42,626€ është si pasojë e mos emërimit me kohë të Bordit Mbikëqyrës të ARH-së;
- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte zvogëluar me vendim të Qeverisë në shumë 42,126€ pasi që ARH nuk kishte arritur të shpenzojë buxhetin e ndarë si rezultat i mungesës së kontrolleve buxhetore dhe mungesës së Bordit; dhe
- Buxheti për shërbime komunale është zvogëluar për 5,522€ me rishikim buxhetor dhe vendim të Qeverisë, si rezultat i mos realizimit të planit sipas parashikimeve.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Deri në fund të vitit ishte shpenzuar tërë buxheti i kësaj kategorie në vlerë 124,918€. ARH kishte të aprovuar nga Kuvendi 20 punonjës përfshirë edhe katër (4) anëtarët e bordit të cilët janë emëruar nga Kuvendi i Kosovës në fund të muajit tetor 2016.

Çështja 5 - Menaxhimi i dosjeve të personelit - Prioritet i mesëm

E gjetura Testimi i mostrave në fushën e personelit ka identifikaur këto dobësi:

- ARH ende nuk ka filluar të aplikoj Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njërëzore (SIMBNj), përmes së cilës menaxhohen informatat për secilën dosje të personelit. Kjo ka ndodhur për shkak të vështirësive në përdorimin e këtij sistemi; dhe

- Dosjet fizike të personelit nuk ishin mirë të organizuara sepse mungonte një sistematizim i informatave që përmbanin. Gjithashtu, nga shqyrtimi i mostrave të testuara kemi identifikuar se dy (2) dosje të punonjësve nuk përmbanin disa nga dokumentet e nevojshme rreth përvojës së punës siç kërkohet me vendimin e qeverisë.

Rreziku Mos aplikimi i SIMBNj dhe dosjet e pakompletuara të personelit rezultojnë me papajtueshmëri me kërkesat e rregulloreve për menaxhimin e personelit si dhe reduktojnë menaxhimin efektiv të personelit.

Rekomandimi 5 Kryesuesi i Bordit duhet t'i forcojë kontrollet në menaxhimin e personelit për të siguruar harmonizimin e të dhënave dhe plotësimin e dosjeve të personelit dhe azhurnimin sistematik të tyre si dhe aplikimin e plotë të SIMBNj-së. Sfidat në përdorimin e SIMBNj-së duhet të adresohen në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike përfshirë edhe trajnimet e nevojshme për stafin.

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë edhe ato komunale në vitin 2016 ishte 78,431€, ndërsa ishin shpenzuar 76,334€. Deri në hyrjen në fuqi të ligjit 05/L-092³, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik të Prokurimit Publik, ARH kishte nënshkruar pesë (5) kontrata publike, ku katër (4) nga ato ishin zhvilluar përmes procedurave të kuotimit të çmimeve dhe një (1) përmes procedurave me vlerë minimale.

Çështja 6 - Zotimi i mjeteve pas nënshkrimit të kontratës - Prioritet i mesëm

E gjetura Testimi ynë i pajtueshmërisë ka identifikuar që kontrata "Shërbime të përkthimit nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe serbe" në vlerë 1,756€ ishte nënshkruar pa u bërë zotimi i mjeteve. Zotimi dhe urdhërblerja ishin nënshkruar një (1) muaj pas nënshkrimit të kontratës.

Rreziku Nënshkrimi i kontratës pa zotim të mjeteve mund të rezultojë në krijimin e obligimeve pa u siguruar mjetet e mjaftueshme buxhetore. Kjo rezulton me rritje potenciale të obligimeve të ARH-së dhe pagesën e obligimeve nga buxheti i viteve vijuese.

Rekomandimi 6 Kryesuesi i Bordit duhet t'i forcojë kontrollet buxhetore dhe të prokurimit si dhe të sigurojë që mjetet zotohen para nënshkrimit të kontratës publike. Urdhërblerja duhet të nënshkruhet pas nënshkrimit të kontratës dhe para pranimit të mallrave dhe/apo shërbimeve.

³ Me këtë ligj është përcaktuar që për agjencitë e pavaruara të cilat i përgjigjen Kuvendit të Republikës së Kosovës, që kanë më pak se 50 punonjës procedurat e prokurimit i zhvillon Agjencia Qendrore e Prokurimit.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Bazuar në shpalosjet e pasurisë në PVF e vitit 2016 dhe sipas regjistrit kontabël të thesarit, vlera neto e pasurisë kapitale ishte 17,914€, ndërsa vlera neto e pasurisë jokapitale ishte 5,232€. Në fund të vitit ARH kishte bërë njehësimin fizik apo inventarizimi i pasurisë jofinanciare.

Çështja 7 - Moszhvlerësimi përmes e-pasurisë - Prioritet i mesëm

E gjetura Auditimi ynë ka identifikuar që në sistemin qeveritar e-pasuria nuk zbatohet zhvlerësimi i pasurive nën 1,000€. Si pasojë, vlera neto e pasurive në këtë sistem paraqitet e njëjtë me vlerën e blerjes. Sidoqoftë, zhvlerësimi i këtyre pasurive ishte kryer në mënyrë manuale nga zyrtari i pasurisë në ARH dhe vlera e tyre në PVF nuk përmban gabime materiale.

Rreziku Funksionimi i mangët i sistemit e-pasuria vështirëson menaxhimin adekuat të pasurisë dhe rrit rrezikun e gabimeve gjatë llogaritjes manuale të zhvlerësimit. Kjo poashtu mund të rezultojë me mos përmbushje të kërkesave të kontabilitetit dhe raportimit financiar të pasurisë.

Rekomandimi 7 Kryesuesi i Bordit duhet të iniciojë dhe kërkojë një rishikim të sistemit e-pasuria nga Ministria e Administratës Publike për të konfirmuar që ky sistem përmbush kushtet për të siguruar se regjistrimi dhe menaxhimi i pasurisë bëhet në përputhje me kërkesat e rregullorës nr. 02/2013. Po ashtu duhet të sigurohen trajnimet e duhura për stafin e ARH-së përgjegjës për zbatimin e këtij sistemi.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 19,270€. Kjo shumë përfshinë kompensimet të anëtarëve të bordit në vlerë 11,215€ të cilat janë paguar në janar të vitit 2017, si dhe obligime të papaguara ndaj furnitorëve në vlerë 8,0560€ për mallra dhe shërbime. Shuma e këtyre obligimeve kryesisht është rezultat i pranimit të faturave me vonesë. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.5 Rishikimet specifike te Qeverisjes	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.			Nuk janë marrë masa.
2.5 Rishikimet specifike te Qeverisjes	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit administrativ dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri më 1 tetor 2016.	Po		
3.5 Menaxhimi i pasurise	Ndonëse janë marrë disa veprime nga Drejtori i Përgjithshëm, megjithatë me qëllim të evitimit të çështjeve të theksuara, duhet që të njëjtat të adresohen tek bordi i ri i ARH-së. Kjo nënkupton edhe një monitorim të mirëfilltë të aseteve dhe mjeteve themelore, në mënyrë që prezantimi i pasurisë të jetë i drejte si dhe të parandalohen keq përdorimet eventuale.		Janë marrë disa veprime por ende kërkohen përmirësime.	

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
 Regullativni Autoritet Železnica
 Railway Regulatory Authority



NR PROT BR PROT NR PROT	02	NR PROT BR PROT NR PROT	488
NR PROT BR PROT NR PROT	1	NR PROT BR PROT NR PROT	05/06/2017
PRISHTINE / A			

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Shkëlzen Qorri,

UD Drejtor i Përgjithshëm

Data: 05/06/2017

